



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.04.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen të mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 22.


Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkyetar **z. Fatmir Iska**, i nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-i medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të katërt me radhë të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – mars 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për transparencë në Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-08152-0, ZK-Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-08152-0, ZK-Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënie të pronës me qira, P-01496-0, ZK-Retijë;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formim të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01496-0, ZK-Retijë;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-08994-0, ZK-Rahovec;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor);
12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të pronës komunale stacionit policor në Rahovec; (eliminohet)
13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);
14. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në komunën e Rahovecit, për vitin 2024-2025.

Shtesë:

1. Shfuqizimi i vendimit Nr. prot. 01 Nr.21/25, i datës 28.02.2025 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike.
2. Vendimi për pëlqimin paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
3. Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.



Kryesuesi: Të nderuar kuvendarë, ju informoj që i kemi edhe 3 pika shtesë: Shfuqizimi i vendimit Nr. prot. 01 i datës 28.02.2025 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike. Pika e dytë: Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe pika tjetër shtesë ka të bëjë me pëlqimin paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të hotelierisë dhe gastronomisë, përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. Sa i përket pikës shtesë për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, kjo është pjesë e parcelës ku aktualisht është ish Hotel Plaza. Këto dy parcela edhe ashtu kanë qenë në shfrytëzim në të kaluarën nga i njëjti pronar dhe pas takimeve të fundit me komisionin profesional të kësaj lëmie, si dhe pas vendimit të fundit të kuvendit për dhënien në shfrytëzim për 99 vite për parcelën që aktualisht është hoteli. Pas ligjshmërisë të këtij akti të kuvendit, kemi dalë në terren, dikush edhe prej asambleistëve ka qenë në atë përbërje që t'i ndihmojmë komisionit profesional në lidhje me kriteret. E kemi parë që është jofunksional hoteli, nëse ne vazhdojmë pa këtë pjesë. Do të thotë, bëhet fjalë edhe për 9 ari e 69m², ku aktualisht është terrace e hotel "Park Plazës". Në seancën e kaluar nuk e kemi futur në kuvend këtë parcelë, për shkak të punimeve që po i realizojmë në shesh. Tani, shumica e punimeve të vrazhda në atë pjesë janë në përfundim e sipër dhe bazuar në arsyeshmërinë që mund të vie nga presidentja e Republikës së Kosovës se cilat vendime mund t'i marrë kuvendi dhe cilat jo, e kemi parë të arsyeshme që kjo parcelë të funksionalizohet që komisioni të hapë thirrje për ankand publik. Një material tjetër që ju ka ardhur në email (një e drejtë kalimi) që nuk është në rend dite, po e tërheqim përsëri, sepse pala ju ka drejtuar kryesuesit dhe kryetarit, lënda është në zyrë ligjore për shqyrtim. Një material që para pak qastesh e morët fizikisht, ka të bëjë me kërkesën e drejtorit të përgjithshëm të policisë së Kosovës, për shfrytëzim të disa ari që faktikisht janë në shfrytëzim prej policisë. Parcela është përpara objektit të stacionit të policisë. Kërkesa e drejtorit të përgjithshëm të policisë ka ardhur dje pasdite, pas orës 3 dhe jemi munduar sot ta bëjmë vendimin dhe pikërisht kjo është arsyeja që sot po ju dorëzojmë fizikisht. Te pika e sheshit qëndror, është edhe pika e komisionit i cili do t'i zhvillojë procedurat.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për kryetarit, ekzekutivin, kolegët asambleistë, të pranishmit. Ky ndryshimi i vendimit për zgjerimin e dhënies në shfrytëzim për 99 vite, a e ka qëllimin vetëm për ta ndërruar komisionin të dhënies në shfrytëzim, apo ku është problemi?

Afrim Oruqi: Në seancën e fundit, kur e kemi marr vendimin për dhënien në shfrytëzim të atyre 20 ari e disa m² për hotel, kemi formuar edhe komision. Tani është vendimi për një parcelë tjetër dhe sipas ligjit kërkohet të formohet edhe komisioni. Është e drejtë e juaja nëse dëshironi t'i legjitimoni anëtarët e njëjtë.

Burim Krasniqi: Kërkoj falje! Parcela e terracës së hotelit, a llogaritet të jetë pjesë e një projekti bashkë me hotelin? Atëherë, pse nuk e gjeni një modalitet që këtë pjesë t'ia shtoni atij vendimi, sepse nuk ka logjikë një komision për terracë, një komision për atë. Në fund, parimisht do të jetë i njëjti fitues i projektit. Nëse nxjerren dy vendime, bëhen dy komisione, ai duhet të aplikojë dy herë dhe kjo është e palogjikshme. Të bëhet vendimi që plotësohet vendimi paraprak, nëse mund të bëhet ky format?

Kryetari: Përshëndetje kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtorë, nënkryetar, media, KFOR. Burim, keni të drejtë, por proceduralisht ne duhet ta bëjmë edhe një komision, sepse dje ka ardhur ligjshmëria e vendimit të kaluar dhe tani të bëjmë plotësim-ndryshim të të njëjtit vendim është procedurë, por unë propozoj që të legjitimohet i njëjti komision dhe ta marrë përsipër edhe këtë parcelë si dhe për tërë projektin. Vendimi le të merret edhe për këto 9 ari dhe komisioni të jetë i njëjti.

Burim Krasniqi: Në këtë kuptim jam laik, por, në momentin që bëhet thirrja për aplikim, të jetë një thirrje për komplet parcelën duke i përfshirë dy vendimet e asamblesë. Kërkoj mirëkuptimin nga kryesuesi, sekretaria e kuvendit, komisioni si dhe nga zyra ligjore, që kur ta bëjnë thirrjen të bëhet një e vetme që mbështetet në këto dy vendime.

Afrim Oruqi: Pas konsultimit me zyrën ligjore, i kemi dy rrugë: Të plotësojmë-ndryshojmë vendimin e ligjshmërisë të ardhur të mbledhjes së fundit. Do të thotë, këtij vendimi t'ia shtojmë edhe këtë parcelë me këtë sipërfaqe, duke mos e "ngucur" komisionin. Rruga e dytë: Nëse e votojmë këtë vendim sot, vendim të vecantë me këtë sipërfaqe, atëherë duhet ta formojmë edhe një komision për zhvillimin e procedurave. Ju mund t'i propozoni anëtarët e njëjtë, por zyra ligjore rekomandon që ta plotësojmë-ndryshojmë vendimin e fundit. Vendimit t'ia shtojmë edhe një paragraf me këtë parcelë me 9 ari.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Pas diskutimeve, pikat shtesë i vendosim në votim! Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (20) votohen pikat shtesë në rend dite. Të nderuar anëtarë të kuvendit, tani e vendosim në votim rendin e ditës. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet rendi i ditës për mbledhjen e katërt të rregullt.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Konstatohet që unanimsisht (22) votohet pika e parë.

2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive, media, zyrtarë komunalë dhe ju të pranishëm. Fillimisht, i kam dy pyetje për ekzekutivin: Në lagjen prej nga vij unë, prej fillimit të mandatit kam pasë kërkesë të vazhdueshme për çështjen e trafos së energjisë elektrike, e cila ende edhe pas 3 vite e gjysmë nuk ka marrë formë dhe nuk është afër finalizimit. Ju ftoj që, sido që të jenë procedurat dhe sado e vështirë që të jetë, unë ju ftoj që të bëhet maksimumi dhe kjo çështje të përfundojë sa më shpejtë, të paktën deri para fillimit të stinorit dimëror, kur konsumi është më i lartë dhe nevoja gjithashtu më e madhe. Pyetja tjetër për kryetarin: ka qenë një thirrje e fondit të Bashkimit Evropian për zgjerimin e fuqisë së evropës. Ka qenë diçka shumë e thjeshtë, me anë të një aplikimi të kemi wi-fi falas brenda qytetit. Nuk e di nëse komuna jonë ka aplikuar, por ka edhe thirrje të tjera edhe për zhvillim të agro-turizmit. E kam një çështje tjetër më delikate – roli i mediave, i cili është shumë më i rëndësishëm, sidomos në nivelin lokal. Një individ, i cili ka hapur një faqe në facebook dhe po vazhdon me propaganda të llojit të vet, i cili nuk del përtej lagjes së tij dhe nuk shikon përtej hundës së tij. Ky individ po bën shpifje të vazhdueshme kundrejt njerëzve që mundohen sinqerisht ta bëjnë një të mirë, apo një kritikë ndaj pushtetit lokal, për të cilin kërkojmë mirëkuptim, por edhe llogarisim që është nxitje për punë dhe zhvillim. Në një postim të bërë, thotë që: "Defrim Kafexhiu do të kalojë në aleancë". Gjatë këtij mandati ka pasur shumë thashetheme, gjatë kohës kur kam qenë kryesues dhe gjatë kohës kur jam shkarkuar. Kjo është vetëm një shpifje e llojit të vet, e njerëzve pa pikë karakteri dhe pa pikë morali. Këtu është ala më keq që politika nuk është thashetheme, politika nuk është fjalë goje, as autolarje e as call center që të dështojë. Politika nuk është as organizatë joqeveritare që t'i keqpërdorësh fondet dhe me ato para të krijosh propaganda politike. Ende më i keq bëhet fakti, kur këta njerëz pa identitet dhe pa karakter, sigurojnë hapësirë politike nëpër parti të caktuar institucionaliste që unë i llogaris këta sikur "mortje politike". Këta individë, që dikur e kanë mbështetur Lëvizjen Vetëvendosje nga jashtë, se nga brenda nëse e mbështetë Lëvizjen Vetëvendosje duhet të kesh karakter dhe sinqeritet, si dhe gjithkujt nuk i ofrohet mundësia të jepe kontribut, sepse ne dëshirojmë të fitojmë, jo të humbasim. Partitë që i kanë krijuar hapësirë këtij individ, më vjen keq për ta, sepse janë njohës të mirë të politikës dhe institucionalista. Ata e kanë marrë një "mortje" për të cilin do ta shohin në rezultatin në zgjedhjet e ardhshme lokale, por e kanë parë edhe në zgjedhjet e kaluara nacionale. Këta njerëz, maksimumi që mund të jenë është "kandidat" në listat e tyre politike, në partitë që i kanë 12%, jo në parti tjera. Këtyre njerëzve, kur iu ofrohet më shumë hapësirë politike pa meritë dhe pa mbështetje elektorale, nuk mund t'i quaj ndryshe, përpos "mortje" për një parti politike stabile, sukur që është një parti institucionaliste. Politika është sport i rëndë dhe

nuk është për gjithkë. Në politikë “matemi” në zgjedhje dhe rezultati e definon kuptimin e punës politike. Nuk është politika që të bëhen postimet vetëm brenda oborrit të tij. Politika nuk është për shpifje dhe të merresh me “llafe të grave” – më falni në shprehje. Në politikë janë dy kategori të njerëzve: Mund të jesh burim i pozitivitetit, nxitës i proceseve që e përmirësojnë jetën e qytetarëve, por mund të jesh edhe mi i kanalizimit. Në këtë të dytën është individi, i cili është strukur në ombrellën e një partie politike dhe në një faqe brutale – katastrofale të facebook-ut.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Dola të diskutoj rreth pikave të rendit të ditës. Kryetar, e kam pasur një kërkesë për çështjen e furnizimit me lëndë djegëse – ndërprerje të kontratës, a ka ndonjë veprim konkret? E dyta, e kam një kërkesë që disa seanca. E kam kërkuar renditjen e kompanive sipas ofertave për tri projektet që janë të evidentuara në raport të auditorit gjeneral dhe mbi bazën e asaj që është mbështetur në planin dinamik? Nuk kam marrë asnjëherë përgjigje! Sekretaria e kuvendit, e ndihmoni drejtorin për këto pyetje. E fundit, i bashkëngjitem ftesës dhe kërkesës së Defrimit. Kryetar, ekzekutiv, zyrë ligjore, kërkoj mirëkuptim që nëse ka hapësirë, që komuna të nxjerrë një rregullore të brendshme mbi bazën e ligjit për media, e cila e rregullon formatin e sjelljes së portaleve lokale në komunën e Rahovecit. Kërkoj që, secili portal që merret me “fiskultura” të japë përgjegjësi. Dhëlpërs kur iu ka djegë bishti, ka menduar që është kallë dynjaja”. Duhet të bëhemi korrektë dhe të kërkojmë përgjegjësi prej secilit portal edhe atëherë kur fotografohet njeriu në ceremoni mortore dhe bëhet lajm medial. Kur fillon të luash, pritni më pas edhe tjerët. Bën edhe si ekzekutiv ose si asamble, ta nxjerrim një kërkesë dhe t’i drejtohem KPM-së për të ndërmarrë masa ndaj të gjitha portaleve lokale që merren me këso gjërash. Ose ta bëhet një komision monitorimi, që i përcjellë krejt postimet e krejt portaleve në komunë të Rahovecit dhe me ato postime t’i drejtohem KPM-së. Parimi nuk e kupton një të pestën, por e kupton tërësinë. Jam “pa pardon” ndaj të gjitha portaleve lokale dhe para çdo fjalimi këtu në asamble komunale. Të japim përgjegjësi. Sa i përket të ardhmes politike, secili e ka përgjegjësinë e vet dhe qytetari vendosë kush fiton e sa fiton. Unë kom pas qejf të bëhet kryetar komune, por Smajl Latifi u bë, qytetari vendosi dhe kjo është çështje demokratike. Qytetari vendosë kush bëhet deputet, asambleist dhe secilën pozitë.

Bejtullah Deliu: Faleminderit i nderuar kryesues! I nderuar kryetar, zëvendëskryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media, pjesëtarë të KFOR-it dhe të gjithë të pranishëm. Dëshiroj të ndërlihem te dhënia e qerasë për 99 vite për hotelin. Si kërkesë ishte që të formohet një komision i jashtëm profesional. Në një postim të kryetarit me një grup punues. Në postim, në paragraf të parë shkruan: “Sot, bashkë me ekspertë të fushës së hotelierisë, turizmit, gastronomisë dhe arkitektë e bashkëpunëtorë të mi, u mbledhëm për të diskutuar për të ardhmen e hotelit në sheshin qëndror të Rahovecit”. Kryetar, nuk e di kush ju ka këshilluar kështu, për formimin e këtij komisioni, duke e pasur në maje një biznesmen që është edhe kryetar i gastronomeve, Petrit Kllokoqi. Çka ka lidhje të marrë pjesë një gastronom. Këtu kemi të bëjmë me ndërtimin e një objekti dhe gastronomia na duhet pas ndërtimit dhe në momentu kur çdo gjë është gati për klientët. Për ndërtim, ty të duhen profesionistë edakuatë, që me bollëk janë në komunën tonë. Në vend që të thirret arkitekti i dëshmuar ndërkombëtarisht, Arbër Shala, ju e ftoni Petrit Kllokoqin. Në vend që të ftohet Destan Gashi - skulptor, ju e ftoni Petrit Kllokoqin. Në vend që të ftohet Agi Haxhimurati – dizajner i njohur ndërkombëtarisht, ju e thirrni Petrit Kllokoqin. Në vend që të thirren artistë të shquar, si Florent Pista dhe Fehmi Hoxha, të cilët kanë dëshmuar që mund të kryejnë punë si komision, ftohet një gastronom. Bota ka filluar të punojë më ndryshe duke punuar me inteligjencë artificiale, kurse ne merremi me një gastronom për një projekt madhor, që duhet të jetë sa më i mirë. E kemi Bardh Sokolin, që në këtë aspekt po dëshmohet. Nuk ftohen këto figura, por ftohet një gastronom, që në fakt gastronomia nuk ka lidhje fare me ndërtimin e një objekti. Nëse është ftuar në cilësinë e njohësit të agroturizmit, mendoj që edhe këtu është bërë një gabim trashanik, sepse i kemi të dëshmuar organizatorët e HardhFestit– festival i pranuar ndërkombëtarisht, Agron Sokoli me ekipën e tij. Ju lutem, konsiderojeni mirë dhe bëjeni një komision profesional me arkitektë të dëshmuar, me inxhinierë dhe artistë që kanë dhënë kontribut këtu. Kryetar, siç duke projektet më madhore po ju dalin të dështuara, sepse projektit ia filloni “tu pa – tu bë” dhe ndërkohë filloni me ndryshime. Projekti po fillon pa asnjë analizë, pa një studim paraprak dhe tutje na dalin telashe të mëdha. Projekti nga pompa e shtetit deri te stacioni i autobusëve, rruga që ka qenë me muaj të tërë e demoluar dhe bizneset kanë pësuar shumë. Kjo rrugë, përsëri po del e

dështuar si projekt, sepse në momentin që bijnë “dy riga” shiu, ju del “puna” që e keni bërë aty. Projekti tjetër, në një postim me pensionera e keni bërë një “shfaqje teatrale”, duke iu siguruar edhe transport deri te objekti për pensionera, por ai transport më nuk ekziston. Gjithashtu, para tre viteve e keni vendosur një komorë kinse si pikë grumbulluese dhe nuk ka asnjë lëvizje. Kur kemi mungesë të analizave të thukta, projektet të dështojnë. Projektet e vetme që keni mundur t’i bëni, kanë hapësirë dhe janë funksionale janë në mandatin e dytë, të cilave veç ia keni prerë shiritin dhe projektet janë të ish kryetarit, prof. dr. Idriz Vehapi. Nuk kemi fare ndërtesa kolektive, falë vonesave që i bëni. Këtu nuk është fajtorë veç ministria, sepse kërkesa për hartë zonale është dashur të bëhet shumë më herët. Ishte një projekt atje në pronë private që është dashur të ndërtohet dhe ju si komunë në vend që t’i ndihmoni, jeni munduar t’i sabotoni ata. Në vend që të shfrytëzohet vendimi i ministrisë dhe t’i jepet leja, ju e keni ndalë. Kryetar, për herë të parë e keni një projekt në dorë, të mirëfillt ashtu siç është sheshi qëndror dhe hoteli, si dhe nëse edhe këtu nuk ndërmerrni hapa që të punoni me profesionistë, atëherë besoj që edhe ky projekt do të jetë i dështuar, ashtu siç kanë qenë shumë projekte tjera. Në fund, rreth punësimeve në komunë. Më besoni që, paraprakisht dihet se kush duhet të pranohet në vende të caktuara. Në moment që shihen në facebook figura të reja që ju bëjnë “share”, dihet që në një të ardhme të afërt, ky person ose një familjar i tij do të punësohet.

Kryetari: Djali im i ka pasur 11 vjet, kur ata që merren me propaganda kanë thënë që vozit BMW, e në fakt BMW nuk kam pasur asnjëherë. Qëllimi ka qenë që të bëhen fushata të tilla, që i konvenojnë dikujt për t’i fituar zgjedhjet. Kur jemi te shpifjet, nuk mund t’i ndalojmë. Për ankesa është komisioni i pavarur i medias, apo edhe policia e Kosovës. Nuk është temë e kryetarit të komunës, nëse një portal lokal është i regjistruar ose jo. Më vjen keq që ka shpifje dhe improvizime. Është një “mesele” që tregohet në mes të deles dhe dhisë dhe ata që janë më të vjetër e dinë. Unë vazhdimisht ballafaqohem me situata shpifëse, të cilat veç më forcojnë. Këto shpifje, jo vetëm që s’i meritoj si kryetar, por nuk i meritoj as si njeri - as unë, as askush. Ka insinuate që prekin në çështje familjare dhe privatësie, që kurrë në politikë nuk është dashur të jenë standard. Fatbardhësisht, prej vitete të 90-ta unë e kam të qartë se me çka duhet të merret dhe me çka jo, një njeri që është i pozicionuar të punojë për interes ë përgjithshëm. Asnjëherë nuk e bazoj politikën në kritere dhe deklarime të ulëta. Në vend që të bëhet një kritikë e shëndoshë me qëllim të përmirësimit, bëhet nxitje. Tani, nuk më bëjnë fare përshtypje ashtu siç ka thënë Ramiz Lladrovci – “nuk i lexoj fare”, sepse në kuptimin e karakterit, bindjes, vlerës dhe ideologjisë, jam më i fortë vetë se sa krejt portalet bashkë, përkundër faktit që portalet i respektoj. Defrim, kemi aplikuar për wi-fi dhe te të gjitha thirrjet të cilat e përfshijnë komunën i rrimë gati dhe jemi përfitues në plot projekte të Bashkimit Evropian. Madje edhe pse sjemi komunë kufitare, aplikojmë edhe në projekte ndërkufitare me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Jemi përfitues në disa projekte me Qarkun e Kukësit, Bashkinë e Kukësit, Komunën e Haraçinës dhe tani së fundi kemi aplikuar edhe në një thirrje me Komunën e Sarajit në Maqedoninë e Veriut. Lista e realizimit të projekteve të tilla është e gjatë dhe e ftoj shefin e kabinetit që në seancën e radhës ta kemi listën e plotë. Pavarësisht a jemi pozitivë apo opozitivë, nuk është mirë që askush t’ia ketë inatin komunës së vet. Te ndërtimet e larta: duhet t’i dimë aspektet ligjore, që dikush të thotë për dikë “e sabotoi”. Përkundrazi, unë kam qenë “për”, por nuk mund të ndërhyj, sepse nuk përfaqësoj politika të diktaturës. Unë bërtas, por marr shumë ide dhe i dëgjoj bashkëpunëtorët e mi. Nuk mund t’i them, Albtor, nënshkruaje këtë leje, kur një dokument është në kundërshtim me ligjin dhe PZhK-në. Sa i përket hartës zonale, unë e kam trashëguar atë dhe ka qenë dikush tjetër para meje 4 vjet dhe nuk është bërë asgjë. Dokumentet e tilla marrin kohë. Janë dokumente strategjike që varen nga puna e ministrisë. Sa i përket grupit të ekspertëve: A jeni ju të njëjtit që morët vendim dhe ma dhatë autorizimin mua? A mendoni që unë jam aq njeri i “pacipë” që t’ia kem inatin një projekti kaq të madh. Kush ka qejf më shumë se kryetari të jetë një hotel i mirë në qytet?! Unë e kam bërë grupin e ekspertëve dhe ju kam thënë që do t’i drejtohem legalisht me protokoll, Odës së Hotelierisë dhe Turizmit në Republikën e Kosovës dhe më është përgjigjur profesor dr. Hysen Sogojeva, që është i fushës. Ju kam drejtuar Shoqatën së Gastronomëve të Republikës së Kosovës dhe këtu nuk është mirë të shënjestrohet kërkush nga askush, sepse emri që u lakua shpeshë ka miq në Rahovec dhe ndoshta ai i konsulton përditë ata. Unë ju kam besuar arkitektëve të komunës, madje dy prej tyre janë nga kuvendi i komunës së Rahovecit,

Merisa Sharku dhe Drilon Mustafa. Është punë arkitektonike, punë stili, punë turizmi edhe punë gastronomie etj... Pra, kryetari i komunës është kryesues i këtij grupi dhe janë tre drejtorë: drejtori për ekonomi, i gjeodezisë dhe i urbanizmit, si dhe tre të tjerë janë nga asambleja, Merisa, Driloni dhe Rumir Zhuniqi. A e dini që Rumiri ka qenë anëtar i festivalit të vjeljes së rrushit dhe ky komunikon në baza ditore me Agron Sokolin dhe me të tjerët.

Bejtullah Deliu: Kryetar, jeni duke folur pak më zgjeruar dhe po ju duket që unë kam folur keq për Petritin. Unë e ceka që është ftuar gabimisht dhe gastronomia nuk ftohet në ndërtim. E dyta, komisioni jorastërisht është kërkuar të jetë komision i pavarur. Ju e përmendët që i kam tre drejtorë, i kam tre asambleistë dhe çka i bie kjo? Cili është ndryshimi i komisionit të jashtëm dhe të brendshëm? Çka ka lidhje turizmi me ndërtim të objektit? Objekti si objekt nuk ka të bëjë me gastronomi. Gastronomi vjen pas ndërtimit dhe tutje është plani si t'i tërheqim vizitorët apo si të shërbehet aty. Unë Petrit Klllokoqin personalisht e njoh dhe e kam mik, mund ta dëshmoj, mirëpo, nëse e njeh Petritin dhe ai i njeh 40 vetë tjerë, t'i japim hapësirë gastronomit për një ndërtim të një objekti.

Kryetari: Nuk e kam ndërmend të shtyhem me këtë mençuri të shprehur, gati në përmasa strategjike. Ju lutem, unë e kam një vendim të kuvendit këtu. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të komunës është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktiviteteve biznesore të hotelierisë dhe gastronomisë, ku do t'ju jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone. O njerëz, unë ju besoj të dy arkitektëve, Merisës dhe Drilonit dhe kuptojeni që dy arkitektë i kam në grup. Po flisni kot, ju lutem, kemi gjithashtu inxhinierë të komunës, të cilëve gjejmë forma që edhe atyre t'ju marrim ide. E kemi udhëheqësin e Shoqatës të Gastronomëve të Kosovës, e kemi udhëheqësin e Odës së Hotelierisë dhe Turizmit. Prandaj, këndvështrimi i kryetarit të komunës bazohet në vendimin e kuvendit, kërkesat e kohës dhe në involvimin e akterëve që mund të luajnë një rol pozitiv. Nuk mund të bëj grup punues me 70 vetë, por e kam bërë një grup punues që ka arkitektë, asambleistë, specialistë të hotelierisë dhe turizmit dhe udhëheqësin e gastronomisë. Ne po diskutojmë për një mundësi reale që ta ketë një hotel të ndërtuar mirë dhe të sajuar në atë mënyrë që të jetë në harmoni me sheshin dhe me vlerat e trashëgimisë dhe traditës e identitetit që ka Rahoveci. Pra, ky grup nuk ndërtonte hotel, por ka për qëllim të diskutojë ide dhe ta bëjë një koncept-dokument me kritere sa më të përshtatshme. Sa i përket trafos, është në proces, por ka probleme me pronarin. Jemi në hulumtim të dy parcelave të tjera, pronari një herë e ka pranuar, por tani jo. I lus drejtorët që sot mos të përgjigjen, por të gjitha përgjigjet të jenë me shkrim. Ju lutem, keni kujdes në atë që flisni, sepse ne dimë shumë dhe unë di më shumë se sa mendon, Bejtullah. Populli thotë: “nxjerr një kashtë e dalin gjashtë”. Ky grup do t'i jep ide komisionit të kuvendit, kaq është puna. Komisioni do të ketë mëditje edhe pse Merisa dhe Driloni janë ofruar si vullnetarë. Për të gjitha pyetjet tjera, i lus drejtorët që t'ju përgjigjen me shkrim për seancën e ardhshme.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të kuvendit të komunës, qytetarë të komunës së Rahovecit dhe ju të pranishëm. Kryetari tha përgjigjet do t'ju japin drejtorët dhe është mirë që të përgjigjen, sepse të vetmen përgjigje që e kemi marrë nga seanca e kaluar është nga drejtori i Arsimit. Për pyetjet dhe diskutimet e parashtruara nuk kemi marrë përgjigje. Është kërkesa e familjes së Neki Zllanoga nga Rahoveci, rreth një kanalizimi fekal. Kjo familje ka probleme me punim të tokës dhe çështje tjera dhe është mirë që komuna ta njoftojë rreth kërkesave të bëra. Nuk kanë marrë përgjigje, përkundër pengesave që i kanë me një famlje rreth kanalizimit fekal, i cili derdhet direkt në pronën e tyre. Një çështje tjetër: Drejtoria e Bujqësisë të na njoftojë rreth dëmeve për shkak të vërshimeve të fundit. Për dëmet në pemëtari keni hapë thirrje edhe keni njoftuar që qytetarët t'i dorëzojnë aplikacionet. Në vërejtje shkruan: “për sektorin e vreshtarisë, fermerët nuk kanë nevojë të paraqesin kërkesë, pasi komisioni në këtë sektor është funksional. Disa bujq janë ankuar që ende nuk ka ardhur komisioni. A është duke e kryer punën në terren sipas njoftimit në bazë të kadastrit zyrtar, apo e ka përfunduar punën ky komision? Një çështje tjetër rreth një njoftimi që e ka shpallë Komuna e Rahovecit: “formohet fondi i shpërblimit të raportimit për ndotjen e mjedisit”. Nuk është kjo ndonjë garë se kush të raportojë dhe me sa kam dijeni edhe në vitin e kaluar ka qenë ky fond. Mjedisi mbetet çështje e padiskutueshme që duhet të jetë pastër. Komuna ka disa rregullore rreth kësaj çështjeje. Aty thotë: “shpërblimi është modest, por ndikimi është shumë i madh dhe çdo raportim do të trajtohet me konfidencialitet të plotë”. Si do t'i raportoni

këto të dhëna në raportin e shpenzimeve? Është mirë që komuna ta hapë platformën online dhe raportimi të jetë anonym. Nuk e di komuna apo ekzekutivi kur e ka mbajtur mbledhjen e fundit me përfaqësues të këshillave të fshatrave? Përmes tyre mund t'i diskutojë këto çështje për mbrojtjen e mjedisit dhe jo përmes "fondeve të shpërblimit", sepse kjo nuk është garë.

Edonë Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. I nderuar kryesues, faleminderit për mundësinë e fjalës. Në njërën nga seancat e kaluara kam ngritur si shqetësim kushtet jo të mira të në QKMF në Rahovec dhe QMF-në e Xërxës. Sot e asaj dite, kryetar dhe drejtoreshë nuk e keni marrë asnjë hap. Drejtoreshë, nëse hyn dhe e lexon kuptimin e fjalës "urgjencë" apo "emergjencë", e kupton që nevojë e ngutshme dhe e domosdoshme. Në emergjencën e Rahovecit, për një shërbim të duhet të presësh më shumë se 30-40 minuta, jo nga puna që kanë punëtorët, por nga neglizhenca e tyre. A ka dikush që i mbikëqyr këta punëtorë? Ju flas për nga përvoja para një jave që e kisha me një familjare. QMF-ja në Xërxë është pothuajse pa pastruese. Infermieret obligohen që t'i kryejnë dy punë: t'ju japin shërbim qytetarëve dhe njëherit të pastrojnë vetë. A është e mjaftueshme që në një vend ku kërkohet mirëmbajtja dhe pastërtia, të ketë pastrim vetëm një herë në javë dhe atë me orar të shkurtuar. Të njëjtat pastruese i sjellni poshtë-lart, Rahovec-Fortesë-Xërxë. Drejtoreshë, aparati i biokimisë është jashtë funksionit sot e 6 ditë, mos të themi edhe më shumë. Qytetarët e Rahovecit dhe rrethinës në përgjithësi, janë të detyruar që shërbimet e tyre t'i kryjnë në laboratore private, për disa analiza që ata mund t'i kryejnë për një kosto shumë të vogël 3€, në laboratore private janë 50€. Kërkoj prej jush që të merren masa sa më shpejt rreth këtyre shqetësimeve. Këtu jemi për t'ju lehtësuar jetën qytetarëve, e jo për t'ju vështirësuar. Shqetësimi tjetër është për drejtorin e Shërbimeve Publike: kohëve të fundit kam pranuar shumë ankesa për gjendjen e rrugëve në komunën e Rahovecit, veçanërisht në qytet. E kuptoj që një pjesë e dëmtimeve shkaktohet nga KRU Gjakova, një pjesë nga vetë qytetarët, por përgjegjësia kryesore për këtë kaos bie mbi ju. Ashtu siç dini të mburreni për ndonjë arritje eventuale, edhe pse kohëve të fundit janë të pakëta, po ashtu duhet të merrni përgjegjësi edhe për dështimet që po ndodhin në komunën e Rahovecit. Rrugët brenda fshatit Xërxë janë në gjendje të mjerueshme. Emrat e rrugëve nuk po i ceki, sepse i kam cekë në seancat e kaluara. A keni ndonjë kontratë me ndonjë kompani për mirëmbajtjen e rrugëve? Përveç që janë bërë të vështira për kalim për automjetet, beso që edhe për këmbësorët kur ka reshje të shiut po sjellin vështirësi.

Sejfullah Sejfullahu: Përshëndetje kryesues, faleminderit për fjalën! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleist, KFOR-i shkoi dhe ju media. Po e ndërroj pak kahjen e bisedës, pyetje nuk po bëj, por edhe çka t'i kërkoj kryetarit ndonjë investim, kur edhe ne si opozitë e dimë që i kemi punët keq me buxhet. E kam një shqetësim që e kam përmendur disa herë, sa që edhe jam bërë "bajat" pak. Kryetar, disa herë e kemi biseduar çështjen e shtëpisë së krimatoriumit, apo shtëpisë së masakrës. Dje kam shkuar ekstra për vizitë dhe ajo shtëpi është në gjendje shumë të keqe. Unë nuk kam dalë të bëjë pyetje, kësaj here e kam një kërkesë. Ta shikojmë bazën ligjore që ne ta bëjmë një kërkesë, një peticion të gjithë bashkë, ose të dalim nëpër firma private e ta zgjidhim këtë çështje. Përveç kësaj, familja ka nisë të bëjë planifikime, sepse me të vërtetë na kanë pritur shumë. Ju ftoj që duhet të tregojmë që kemi unitet, për dallim nga qendra dhe duhet të shikojmë nëse është nevoja edhe në grevë urie para Ministrisë së Financave, sepse kjo çështje duhet të zgjidhet me urgjencë. Mos të harrojmë, aty janë djegë njerëz të gjallë. 26 vite pas masakrës, pas djegies së vendit të krimatoriumit të pranuar edhe zyrtarisht nga Tribunali i Hagës, në anën tjetër nuk e kemi marrë asnjë vendim. Mendoj që nuk është me rëndësi, as të bëjmë shkolla më, me gjithë respektin edhe as spitale, para se ta rregullojmë këtë çështje të krimatoriumit. Dy muaj pas masakrës, atë vend e vizituan ish ministri i jashtëm, Robin Kuk dhe ministri i mbrojtjes, Sharping, si dhe zyrtarisht e kanë pranuar si krimatorium. Këtë dëshmi e kemi lënë anash, që pas Holokaustit dhe Sebrenicës e kemi vend të dëshmuar të masakrës. Kryetar, kërkoj që ta shikosh bazën ligjore dhe të shikojmë t'i tregojmë edhe Ministrisë së Financave, Entit për Menaxhimin e Monumenteve dhe Lapidarëve, si dhe kuvendit aktual të pakonstituuar, që nuk është me rëndësi në këtë vend të bëjmë asgjë më tepër, pa e zgjidhur këtë çështje. Asnjë proces tjetër nuk është më me rëndësi se kjo, e as zgjedhja e kryetares së kuvendit të Kosovës.

Kryetari: E mirëkuptoj plotësisht Sefën! Besoj që, të gjithë jemi të informuar për ecurinë e procesit dhe prapë kjo lidhet me trashëgiminë. Para se të vijë unë në pushtet, një komision ka vendosur për një vlerë të caktuar financiare me të cilën nuk është pajtuar pala. Vlerësimin e ka bërë departamenti i financave – komisioni i posaçëm i certifikuar për këto qëllime. 4900€ është vlera që ata e kanë vlerësuar. Prandaj në fillim thash që mos t'i hyjmë këtyre temave, sepse dikush nëpër fushata e ka çelë gojën dhe ka thënë që do të vlerësohet 50.000€ dhe e vërteta është që komisioni ka vendosur ndryshe. Unë kurrë nuk e kam hequr prej prioriteteve shtëpinë e masakrës, kurrë hiç. Ju e dini që tani bëhet fjalë për një parcelë që nëse ka vullnet dikush, ai duhet ta shpreh përmes kompetencave që i ka dhe jo komuna. Komuna po i kryen punët e veta dhe kjo është diçka që lidhet me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Kulturës, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve etj... Ju rikujtoj faktin që bukur disa para i kemi shpenzuar në Muzeun e Masakrës në Krushë të Madhe dhe vazhdojmë ta paguajmë si komunë, punëtorin që është i profesionit dhe ka një pagë modeste. Ju kemi drejtuar organeve përkatëse dhe nuk na kanë dhënë zgjidhje, bile tash në përvjetorin e masakrës këtë bisedë e patëm edhe me presidenten e Republikës. Asnjë investim nuk është duke e bërë Qeveria e Republikës së Kosovës në Muzeun e Masakrës, ndërsa rrahagjoksa bëhen dhe dalin para mediave pikërisht në ditët më të vështira që i kanë Krushianët. Askush nuk mund të thotë që nën udhëheqjen e Smajl Latifit nuk janë ndërtuar muze, janë bërë shumë. Është e vërtetë që Shtëpia e Masakrës ka mbetur keq. E kanë futur në mbrojtje, e kanë ndaluar rrënimin dhe nuk ka investime e as përpjekje të re për shpronësim. Ju e dini si është situata, aty ka probleme me pronar, por, ne do të vazhdojmë me ngulm ta bëjmë punën tonë si komunë. Jam takuar me dhjetra herë, bile pak ditë para zgjedhjeve e kam takuar, nuk ka të bëjë me fushatë, por i ka ardhë rendi dhe kam menduar që po ia mbushi mendjen. Ai nuk e din se me kë të merret vesh, sepse ka edhe dikë që duhet të merret vesh. Pa dashur të flasim për detaje, unë e përjetoj çdo ditë dhimbjen që e ka përjetuar komuna jonë dhe Kosova. Me konsolidimin e institucioneve të reja, shpresojmë dhe do ta shohim mundësinë nëse ka vullnet shtesë për trajtim. E kemi kodin për shtëpinë e masakrës, por nuk po zbatohet për shkak të situatave që për ne janë të qarta. Kjo gjendje ka ndodhur, sepse dikush i ka thënë atij që ti do t'i marrësh 50-60.000€ dhe kur ka ardhur vlerësimi 4900€, ai haptas e ka shprehur mospajtimin. Kjo është situata reale. Ka 8 vjet që merrem me këtë punë, që atij t'ia mbushi mendjen si pronar faktik, jo pronar juridik, që ata mos ta prekin shtëpinë dhe ne ta bëjmë një zgjidhje. Këto nuk janë tema që duhet të diskutohet në këtë kuvend, sepse problemi është diku tjetër. Sa i përket QKMF-së, nuk e manxhojmë ne. Aty është drejtori i QKMF-së, ndërsa ne i bëjmë politikat e shëndetësisë sipas ligjit. Përgjigjet me shkrim do t'i merrni dhe do të befasoheni për të mirë, sepse e vërteta nuk është krejt ashtu siç thuhet në këtë sallë.

Bjondina Kleqka: I nderuar kryesues, kryetar, të nderuar drejtorë të drejtorive dhe ju kolegë këshilltarë. E kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: Te rruga "Asllan Kleqka", a ka ndonjë plan për ndërhyrje të shpejtë, për sanimin e gropave që i hasim në këtë rrugë? Këto gropa paraqesin rrezik për qytetarët, sidomos për ata që kalojnë për herë të parë në këtë rrugë.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përsëritet për të gjithë! E kam një pyetje e shkurtë për kryetarin. Nëse ka mundësi të na informoni më shumë për pozitën që është shpallur për zëvendësrektor në QKMF. A është anuluar kjo pozitë, sepse në ueb-faqe të komunës nuk ka asnjë njoftim?

Kryetari: "I urti i rrahur, me uthull me vaj, mendohet përpara – hap gojën pastaj". Ju lutem keni kujdes, sepse bukur moti jam në këto troje, 400-450 vjet. Të kam thënë edhe atë ditë, nuk futem në këto tema. Jam kryetar dhe njeri i befasive, si dhe mos u befaso herën tjetër kur të flet para kohe. Brenda 5 minutave të mendoj diçka, dikujt i duhet me vite të mendojë. Jam me përvojë, nuk e lendojë askë dhe ju lus të gjithëve që dëshirojnë të merren me politikë, mos të merren me incidente dhe t'ia përmendin një rast në familje etj... Këto nuk janë tema të kuvendit. Në vazhdimësi do të befasoheni veç për të mirë, pavarësisht a ju pëlqen apo jo! Në qoftëse flet "kodër pas bregut" do të befasohesh edhe herave të tjera.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Po më vjen shumë mirë që paskeni menduar për një kohë shumë të shkurtë dhe keni reaguar shpejt. Diçka që është për të mirën e qytetarëve, është shumë mirë.

Kryetari: Do ta marr në konsideratë, bile në librin e memoareve që do ta bëjë pas 30 viteve do ta fus. Vlorë, është kontribut që ta forcojmë angazhimin tim në shërbim të qytetarëve të komunës së Rahovecit, si dhe në shërbim të kombit. Sa më shumë që marr këso këshilla, i mirëpres. Përballë e keni një njeri që nuk ka as pasuri, as asgjë. Nuk bëj improvizime, sepse nuk jetoj përmes incidenteve. E kam të betonuar angazhimin për çështje të qytetarëve, pavarësisht a jam në pozitë, apo opozitë.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Muaj më parë është nënshkruar një kontratë për transport të pensionerave në realicion, Rahovec – shtëpi e pensionerave te Epopeja. Në orarin e përcaktuar realicioni nuk punon. A është ndërruar orari, apo nuk ka vizitorë që e frekuentojnë këtë shtëpi në mal, a është funksionale kjo shtëpi apo jo? Çështja tjetër: te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që ka nënshkruar kontrata me OJQ – përfituese të subvencioneve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit. Ankesat për shpërndarje jo të drejtë, janë drejtuar nga këto organizata drejt nesh, si përfaqësues të qytetarëve. Një prej ankesave vjen nga klubi më i vjetër i shahut në Kosovë, i cili ka marrë një subvencion prej 3200€. Klubi është në superligë dhe brenda tij ka dy kampione të Shqipërisë, një Bullgar dhe një Francez. Me këto fonde minimale ata nuk mund t'i paguajnë as biletat, e lëre më të funksionojnë ashtu siç duhet me pagesa. Gjithashtu edhe klubi i femrave në shah ka marrë një shumë prej 1800€. Ky klub është 3 herë kampion. Ju bëjmë thirrje që të shqyrtohet kjo problematikë dhe mos të lejojmë që një prej klubeve më të vjetra të shahit të shuhet për shkak të neglizhencës sonë. Nëse i hyjmë krahasimit të shpërndarjes së këtyre fondeve, nuk është shpërndarë në mënyrë të drejtë sipas nevojës së klubeve në Rahovec.

Ilir Pallqa: Përshëndetje për të gjithë! E pashë një postim që e ka bërë kryetari për punën e dënimeve. “Dënim ndaj hedhësit dhe shpërblim për atë që raporton”. Nëse unë e ka një video të kryetarit duke e hedhur cigaren në tokë, a dënohet kryetari dhe a shpërblehem unë? Vitin e kaluar më ka treguar një banor që e ka raportuar një rast në inspektoriat, këta të inspektoriatit i kanë treguar personit që ka hedhë mbeturina se kush e ka raportuar rastin. E kemi parasysh se në këtë rast është dënuar raportuesi, sepse i ka dalë problem. Ky rast, më ka nxitur të bëjë tre herë kërkesë këtu në kuvend, që ta kemi një raport me dënimet e shqiptuara. Nuk kam marrë asnjë përgjigje. Zgjedhjet janë afër dhe duhet t'i tregoni “dhëmbët” për ruajtjen e ambientit, sepse del mirë. Realisht, si ekzekutiv për punën e mbeturinave nuk iu ka ndi aq. Vitin e kaluar, në institutin GAP ka rezultuar si i përfunduar premtimi për eliminimin e deponive ilegale, dhjetra të tillë vetë i kam pa në të gjithë komunën. Tani po na dalin dy probleme: mbeturinat dhe jokredibiliteti i institutit me rezultatet e tyre, me të cilat ju si ekzekutiv krenoheni. Urojmë që ky “gazi” parazgjedhor artistik për ruajtjen e ambientit të mos i hutojë banorët e Rahovecit. Ata duhet t'i kujtojnë 4 vite, 3.5 vite bërlllog dhe 6 muajt e fundit pak më pak bërlllog.

Sinan Kryeziu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë këtu në sallë! Dëshiroj ta bëj një falënderim për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve – Afrim Dinën, sepse e kam bërë një kërkesë realisht prej këshillit të fshatit Xërxë. Realisht aty ka qenë nevoja për një kënd të lodrave dhe një minipark, te lokacioni Harley Davidson – rruga Skenderbeu. E falënderoj që kanë filluar punimet dhe Afrimi çdo herë është në dispozicion të merret me komunitetin aty. E kam edhe një kërkesë, njëashtu kemi zotim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike – Përparimin. Në proporcion të planifikimeve për investime sipas buxhetit që e ka komuna jonë, janë bërë më shumë investime se sa ka të hyra dhe kanë shpresuar që do ta kenë një “dorë” nga niveli qeveritar, por fatkeqësisht nuk është bërë asgjë.

Bejtullah Deliu: Faleminderit i nderuar kryesues! Pas përgjigjes së kryetari rreth pikës që diskutuam, që i potencojë dy emrat e arkitektëve që i kemi këtu kolegë, unë them që nuk kam asgjë kundër dhe të marr ndonjë paragjykim se sa janë të aftë për punë, ose jo. Unë jam kundër që komisioni i jashtëm të jetë joprofesional, ndërsa arkitektët që i kemi këtu mund të marrin pjesë në komision i brendshëm. Pasi kryetari nuk është aty, ia përcjellni: rreth shkollës së Retijës, çka paska informata nuk e di, por heshjta nuk është në favor të drejtësisë.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Dëshiroj ta pyes drejtorin e bujqësisë, më duket në shtator e kam ngritur çështjen e një rruge fushore, e cila lidhet prej varrezave të dëshmorëve - në rrafsh të malit dhe del

te rruga e asfaltuar, Fortesë te varrezat e dëshmorëve (te mella). Besoj që drejtori e din për ku po flas dhe nëse nuk jam gabim që drejtori është përgjigjur pozitivisht. Kur do të fillojnë punimet në këtë rrugë?

Drilon Mustafa: Përshëndetje për kryesuesin! Përshëndetje për kolegët! Meqë jemi në temën e komisionit, e ndjeva si obligim që t'ia jap një sqarim kolegut, Bejtullah Deliu. Roli ynë në këtë grup nuk është që ta bëjmë arkitekturën e këtij projekti, por do të ndërhyjmë në atë që aplikon për ta marrë këtë projekt. Do t'ia propozojmë një stil të arkitekturës dhe një detyrë projektuese. Detyrën projektuese nuk mund ta bëjmë vetëm unë dhe Merisa, sigurisht që duhet edhe nga sfera e hotelierisë. Atë ditë, vetëm me një takim nga Petriti kam mësuar shumë. Na tregoi shumë gjëra që rrjedhin që ta ndërtojmë një lokacion të një pishine funksionale. Kur ta bëjmë detyrën projektuese duhet t'ia caktojmë edhe yjet e hotelit, sepse duhet të dimë se çfarë kategorie e shoqërisë jemi. A jemi të pasur të gjithë, apo të varfër. Hoteli duhet të jetë i përballueshëm, sepse mund të mos vizitohet asnjëherë. Secili prej anëtarëve të komisionit i ka përgjegjësitë e veta.

Bejtullah Deliu: Koleg, faleminderit për këtë sqarim, por nuk di se çka sqarove këtu. The që kam mësuar shumë prej Petritit dhe nëse të mëson ty në arkitekturë, hallall i qoftë qenka profesionist. Komisioni i jashtëm, pikërisht në muajin e kaluar unë kërkova që ky komision të formohet dhe kryetari e pranoi, sepse i brendshmi mund të jetë politik, ndërsa i jashtëmi më profesional. Nuk dyshoj në profesionin e juaj, mirëpo, asambleisti të jetë edhe brenda edhe jashtë, pse duhet të jetë kjo? Le të thirret dikush që ka përvojë bukur të madhe. Në pjesën e arkitekturës e dhash një emër që ka renome të madhe. Nuk është keq të marrin pjesë edhe ata edhe ju. Unë e di që të gjithë kemi vullnet që të bëhet një projekt sa më i bukur aty, mirëpo këtij projekti i paraprinë profesionistët. Komisioni i jashtëm, sa më i pavarur dhe profesionist, aq më i bukur do të del objekti. Sa më shumë të interferohet nga ekzekutivi dhe nga asambleistët, ka gjasa që të ketë dështime në pika të caktuara.

Kryetari: Vendimin që e kam marrë me autorizim të kuvendit, pavarësisht se çka thotë Bejtullah Deliu, fare nuk ka peshë më. Unë e kam themeluar komisionin dhe komisioni le të punon me të gjithë, po ashtu edhe me Bejtullahun. Grupi është funksional dhe po e përgatisim takimin e dytë. Eventualisht pas ankandit del një përfitues dhe detyrat projektuese, standartet, si dhe kriteret ia caktojmë ne.

Burim Krasniqi: Kryetar, është mirë që në takimin e radhës të jetë i pranishëm edhe komisioni i asamblesë komunale. Komisioni profesional është në shërbim të komisionit të asamblesë komunale dhe jam i vetëdijshëm që komisioni profesionali do t'i rekomandojë komisionit të asamblesë për kriteret dhe gjëra të tjera.

Merisa Sharku: Dua të kyçem në këtë pjesë, sepse është duke u potencuar disa herë nga Bejtullahu që këta të asamblesë të jenë në komison prej kuvendit. Atë ditë ne nuk u zgjodhëm, pse nuk e ngrite zërin ti dhe të thoje që le të shkojnë këta dy, duke besuar që do të japin kontribut më të madh. Besoj se gjithmonë kam bërë thirrje, që çdo projekt që bëhet në qytetin e Rahovecit, të konsultohemi dhe të marrim pjesë sa më shumë profesionistë. Shpresoj që do të bëhet edhe një thirrje publike për një konsultim publik, në të cilin mund të japim mendimin e tyre edhe qytetarët edhe profesionistët. Unë kam qenë gjithmonë kritikuese ndaj asaj që vijnë shumë pak qytetarë nëpër tubime të tilla. Ju bëj thirrje profesionistave që nëse dëshirojnë të japin kontribut, atëherë të paraqiten nëpër konsultime publike. Do të jem njëra prej iniciatoreve që do të konsultohem me këta arkitektë që i përmende ti, por jo vetëm me ata. Sa më shumë njerëz që i konsultojmë, ideja do të jetë më e plotësuar dhe më e mirë.

Kryesuesi: Faleminderit, Merisa Sharku! Besoj që e kemi përfunduar me pyetje dhe diskutime. Përgjigjet do t'i merrni me shkrim. Shkojmë me një pauzë një orëshe dhe kthehemi në sallë...

3. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – mars 2025:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar dhe ju asambleistë. Raporti financiar 3-mujor përbëhet prej dy pjesëve. Në këtë raport mungojnë aktivitetet e zyrës së prokurimit, sepse deri më tani nuk ka pasur ndonjë ngjarje apo aktivitet për ta vendosur në raport. Raportet e zyrës së prokurimit do të vendosen në raporte 6-mujore e 9-mujore, si dhe raportin vjetor. Për këtë periudhë 3-mujore në total kanë qenë 320.240€ dhe kur bëjmë krahasim me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, kemi një ndryshim negativ në vlerë prej 57.907€. Në raport, raporti 3-mujor me gjoba të

gjykatave dhe të trafikut gjithashtu mungojnë, mirëpo ndërkohë kanë ardhur dhe të hyrat në total janë 91.414€, që bashkë me të hyrat e rregullta bëjnë në total prej 411.628 dhe i krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, atëherë jemi një ndryshim negativ prej 19.490€. Në raport i kam përfshirë edhe disa informata të tjera nga sektori i tatimit në pronë. Në këtë periudhë, deri më tani janë realizuar 160.586 dhe me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka një ndryshim negativ prej 64.000€. Shpenzimi i buxhetit në total është 7.691.245€, 36.66%, pozicioni i pagave 25.87%, mallra dhe shërbime 48.48%, komunal 23.11%, subvencione dhe transfere 14.89% dhe shpenzimet kapitale 54.85%.

Burim Krasniqi: Drejtor, në përshkrim dhe në raport e the që në të hyrat e rregullta ka një trend negativ prej 67.907€, a ka naj shpjegim pse? Te pjesa e të hyrate - tabela 1.6, a është ndonjë gabim apo diçka, realizimi - planifikimi 2025 dhe krahasimi te përqindja është gabim, 627.18% po del, tabela 1.6 – kolona e fundit. Faktikisht këto përqindje janë gabim. Shpenzimet kapitale janë rreth 62% tll shpenzimeve në raport me alokimin dhe nuk kemi asnjë informatë se cilat projekte janë financuar. Për mallrat dhe shërbimet është informata, por jo edhe te shërbimet kapitale. Mendoj që është mirë që ndërkohë të na përcjellni raportin edhe me pjesën e investimeve kapitale dhe ta dimë se cilat projekte janë financuar me shumën prej 62.4%. Te mallrat dhe shërbimet, 51.68% për tre muaj është goxha shpenzim i madh, a ka të bëjë kjo edhe me pjesën përmbarimore apo ku është problemi? Te tabela 3.2 në fund, thotë: për arsye të kalkulimit është bërë shpenzim-planifikim dhe jo shpenzim-buxhetim final, përqindja e shpenzimit e kalon totalin prej 100%. Totali i shpenzimit tani nuk ka mundësi të jetë 100%. Kërkoj që ta kemi për të gjithë asambleistët edhe pjesën e shpenzimeve kapitale.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Te tabela e fundit, te kodi 14060 – mirëmbajtja rutinore, në vitin 2024 ka qenë 22.000€, ndërsa në 2025, 202.000€. Pse kjo diferencë dhe çka përfshin “mirëmbajtja rutinore”?

Lirigzon Kastrati: Te tabela C, te karburantet për vetura të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, në vitin 2024 kanë qenë 12.428€, kurse tani 18.062€, çka përfshihet këtu? Te çështja tjetër, te shpenzimet e vendimeve të gjykatave 4000€ për vitin 2025 për kulturë, rini dhe sport. Për çka janë këto shpenzime? Te mirëmbajtja e objekteve shëndetësore: më intereson nëse keni nënshkruar kontrata të reja. Në vitin e kaluar ka qenë 23.000, kurse tani është 48.600. A janë përfshirë kontratat e reja në këto shpenzime?

Afrim Limani: Burim, përqindja gabim që the, ajo është e programuar me formulë.

Burim Krasniqi: Të kërkoj falje! Realizimi në raport me planifikimin në 2025-ën, në % është 627.18% dhe formula këtu është e shkruar gabim, sepse nuk ka mundësi të jetë kjo.

Afrim Limani: Ka mundësi që të jetë formula gabim, por të garantoj që nuk mundet me qenë gabim dhe çdo gjë shkon sipas formulës. Pse është vlera kaq e lartë e mallrave dhe shërbimeve? Kemi arritur ta bëjmë shpenzimin e buxhetit në atë vlerë, por mos të harrojmë që një pjesë e shpenzimit janë shpenzime që i ka tërhequr thesari, për kontratën kolektive në vlerë prej 450.000. Gjithsej për kontratën kolektive janë tërhequr 1.2 milionë. 500.000 janë tërhequr nga kategoria kapitale dhe 450.000 nga mallra dhe shërbimet. Trendi i rënies të të hyrave të përgjithshme është rezultat kryesisht i tatimit në pronë. Leonard, kjo është një model për raportin 3-mujor financiar, sepse asnjëherë nuk i kemi raportuar me emra. Në raportin e ardhshëm 6-mujor do t'i kesh edhe këto informata. Mirëmbajtja rutinore është kontratë që kemi me kompani të cilat merren me pastrimin e qytetit. Lirigzon, te shërbimet në shëndetësi dhe te mirëmbajtja e objekteve, është kjo kontrata që e kemi për pastrimin higjienik, në shëndetësi dhe në komunë. Te karburantat për vetura ka dallime, sepse ka raste që ka munguar fatura, apo edhe mjetet, si dhe në atë periudhë nuk janë përfshirë. Karborant për vetura, në mënyrë proporcionale hargjojnë sa komuna, aq shëndetësia. Në shumicën e rasteve shëndetësia hargjon më shumë sesa krejt komuna bashkë, sepse janë 4-5 autoambulanca që janë në lëvizje të vazhdueshme.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit drejtor për këto sqarime rreth raportit financiar, jana-mars 2025. Unë e kam një pyetje, e cila ndërlidhet me drejtoritë e tjera. Taksa komunale për leje ndërtimi, planifikimi për vitin 2025 është 86.000€ dhe deri tani realizimi është 1900€. Ku është problemi nëse për 3 muaj janë 1900€, atëherë si të realizohet kjo? Këto tani po lidhen shumë gjëra të tjera, sidomos me Drejtorinë e Inspektoriatit dhe sa gjoba i ka vendosë për ndërtimet pa leje?

Nuk bën të jetë ekzekutivi ose inspektoriati për dikë nënë, për dikë njerë. Nëse nuk ka inkasime për leje ndërtimi, atëherë ndërtimet janë pa leje, si dhe nëse nuk gjobiten të gjithë ata që po bëjnë ndërtime pa leje, nuk është në rregull. Një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike: Këtu besoj që përfshihet taksa komunale për leje ndërtimi edhe për çështje të rrugëve. Në vitin 2023 (nëse nuk gaboj), vetëm në qytet kanë qenë dy kontrata aktive për kubëzimin e rrugëve dhe në qytet janë shtruar vetëm 2000m rrugë janë kubëzuar. Sa prej këtyre rrugëve kanë pasur leje ndërtimore? Këtë pyetje po e bëj, sepse drejtorja e ka refuzuar kërkesën time për kubëzimin e rrugës private dhe ne e kemi kubëzuar vetë me mjete tona. Ndërkohë ka ardhur inspektoriati dhe na ka obliguar që të aplikojmë për leje ndërtimore për shtrimin e rrugës në pronë private. Nëse një qytetar obligohet prej inspektoriatit të aplikojë në Drejtorinë e Urbanizmit, pastaj edhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike për çasje në rrugë tjetër të qytetit. Atëherë, sa rrugë që i ka shtruar komuna kanë pasur leje ndërtimore dhe pse nuk kanë?

Ilir Pallqa: Te shpenzimet e udhëtimeve – transporti: nuk e kam pa që është shpenzuar diçka për transportin e pleqve dhe meqenëse ai projekt ka dështuar, a ka ndonjë hapësirë, për shkak të kursimit të këtyre parave që ta siguroni një autobus për klubet sportive të grupmoshave për fëmijë? Meqenëse busi i vjetër është i papërshtatshëm për rrugë të drejta, e leje më për atje. E keni edhe Skenderin aty që ju informon për gjendjen aty dhe për mungesën e transportin që e kanë, e sigurojnë atë me mjete vetanake.

Afrim Limani: Defrim, në aspektin e financave po të jap përgjigje. Ne e kemi bërë një planifikim real të taksat komunale për leje të ndërtimit, gjithmonë duke bërë krahasim me periudhën e kaluar dhe një analizë të periudhës së tashme. Ne i kemi pasur të planifikuar 86.000 brenda vitit fiskal për 2025. Në vitin 2024 të inkasuara kanë qenë 6000, ndërsa sivjet 1.918.000, që realisht është vlerë shumë e ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Deri më tani, në këtë periudhë ku unë po raportoj, kemi ndryshim pozitiv dhe shpresojmë që deri në fund të vitit fisakt të del planifikimi të cilin e kemi bërë prej 86.000€. Ilir, te shpenzimet e udhëtimit dhe mënyrën që e propozove ti, ta shohim në të ardhmen.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për transparencë në Komunën e Rahovecit:

Blerta Nalli Gashi: I nderuar kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, ju të pranishëm! Besoj e keni analizuar Rregulloren për Transparencë, andaj nuk po zgjatem me e lexu sepse keni patur kohë mjaftueshme. Arsyeja pse kjo Rregullore u kërkuar të hartohet është për shkak të ndryshimit të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna, i cili e ka shfuqizuar Udhëzimin për standardet minimale të konsultimit publik. Rregullorja është unike, u hartua nga kolegji i zyrtarëve për komunikim me publikun në bashkëpunim me MAPL. Rregullorja përmban 9 kapituj dhe 47 nene, të cilat rregullojnë mirëfunksionimin e transparencës në komuna. Për dallim nga Rregullorja e vjetër e cila u miratua në vitin 2019, e cila ka 29 nene, kjo rregullore është më e qartë, më mirë e shtjelluar, specifikon qartë mënyrën e funksionimit të kuvendit komunal dhe ekzekutivit në shërbim të transparencës komunale. Shpejgon më mirë termit e përdorura dhe normalisht obligohet që të jetë në harmoni me Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna. Përmes kësaj rregulloreje na mundësohet që procesi i konsultimit publik për aktet, rregulloret dhe planet strategjike, të jetë më së paku 15 ditë kalendarike e jo më shumë se 30 ditë, përderisa me rregulloren e vjetër ka qenë e specifikuar afati vetëm 30 ditësh i konsultimeve publike. Po ashtu udhëzimi administrativ dhe rregullorja nuk na obligon më që planin e punës së kuvendit dhe ekzekutivit ta vendosim në konsultim publik. Automatikisht vetëm dërgohet në kuvend për miratim. Kjo rregullore ka qenë në konsultim publik për 15 ditë kalendarike, konsultimi me qytetarë nuk u mbajt për shkak të mospjesëmarrjes së qytetarëve në konsultim publik, poashtu nuk kemi marrë asnjë koment në email adresat tona e as nga platforma qeveritare për konsultime publike. Nëse keni ndonjë pyetje?

Defrim Kafexhiu: Faleminderit Blertë për prezantimin. Ne i kemi politikisht bindjet e ndara, por unë nuk dyshoj në aftësitë dhe profesionalizmin e juaj, përderisa keni qenë e përfshirë në hartimin e kësaj rregullore. Unë jam “për” miratimin e kësaj!

Burim Krasniqi: Blertë, më fal që po të thërras në emër! Te raporti mbi procesin e organizimit e keni një gabim teknik, te pjesa e dytë, thotë: “ftesa dhe njoftimet për dëgjimet buxhetore janë shpërndarë ...” kjo kërkon përmirësim.

Kryesuesi: Faleminderit zyrtares për informim, Blerta Nalli Gashi! Atëherë, po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (22) votohet pika e katërt e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP):

Avni Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, drejtoresha, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para jush e keni kërkesën e DKA-së për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore në komunën e Rahovecit. DKA-ja me këtë kërkesë kërkon aprovimin tuaj për dy kandidatët e komisionit përzgjedhës, ku përfshihen shkollat fillore të mesme të ulta, shkollat e larta dhe institucioni i arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe qerdhet. Kandidatët e propozuar nga DKA janë: Lulëzim Krasniqi – Udhëheqës i Sektorit për Arsim dhe Vjollca Vuçitërna – Drejtoreshë e Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në “Selajdin Mullabazi – Mici”. Me këtë kërkesë konfirmojmë se, personat e lartëshënuar i përmbushin kriteret që të jenë anëtarë të komisionit sipas rregullores Nr. 19/24 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve të institucioneve publike edukative arsimore dhe aftësuese në arsimin parauniversitar.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A kemi pyetje apo diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 12 vota pro, asnjë kundër dhe një abstenim votohet pika e pestë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-08152-0, ZK-Rahovec:

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë. Para jush e keni vendimin për dhënie në shfrytëzim një pronë të komunës për 15 vjet. P-08152-0, me sipërfaqe 27 ari e 62m² për qëllime bujqësore.

Kryesuesi: Në mënyrë që ta shohin anëtarët e kuvendit, le të bëhet prezentimi edhe në projektor.

Burim Krasniqi: Qëllimi pse kërkoja këtë pretendim është sepse kjo tokë është në shfrytëzim apo është tokë e punuar? Brenda kësaj parcele ka objekte, në gjeoportali shihen objektet dhe toka është e punuar.

Afrim Oruqi: Ne bashkë me inspektoratin, kur i vërejmë parcelat e komunës që janë të punuar në terren, dalim në terren dhe komunikojmë me shfrytëzuesit e tokës dhe inspektorati i obligon që t’i drejtohen drejtorive përkatëse për kërkesë. Një pjesë e kësaj toke punohet për disa vite me radhë dhe të njëjtit janë obliguar të bëjnë kërkesë në Drejtorinë e Bujqësisë. Qëllimi ynë është që ta ulim numrin e tokave të komunës të punuara padrejtësisht. Atje në atë parcelë, ashtu siç e tha asambleisti është një objekt i përkohshëm – shtëpi bujqësore.

Burim Krasniqi: Drejtor, pa dashur ta gjykoj, nuk e di kush është – kërkoj falje. Nëse dikush shfrytëzon pronën publike dhe ndërton në të, a kualifikohet si uzurpues? E kemi rastin e dytë që na ndodh njëjtë. Njeriu ndërton dhe ne provojmë t’ia legalizojmë. A është standart i keq, nëse dikush ndërton vilë dhe thotë: “e dua me qera, sepse objektin e kam ndërtuar”!

Afrim Oruqi: Thash që, disa toka toka të komunës, në disa zona banorët edhe po i punojnë – kufizohen me këto toka. Në moment kur inspektorati ka hasur në këto prona, ka kërkuar që t’i lirojnë, pa nxjerrë vendim për uzurpim nëse nuk ka ndërtim. Tutje, ka rrjedhë kërkesa në drejtorinë e Bujqësisë dhe i njëjti shfrytëzues në kufi me këtë tokë e ka edhe një tokë tjetër dhe ka kërkuar që ta marrë në shfrytëzim me qera. Ne e kemi futur në listën e pronave për 2025 që do t’i japim me qera. Kjo që po bëjmë tani, nëse ju vendosni do të hapim ankand dhe kërkuesi jo me çdo kusht do ta marrë tokën, sepse sipas ankandit fituesi është kush jep më shumë.

Kryesuesi: Nëse nuk kemi pyetje tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 11 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 abstenim votohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-08152-0, ZK-Rahovec:

Afrim Oruqi: Vendim për formimin e komisionit prej pesë anëtarëve. Dy anëtarë janë nga ekzekutivi, dy nga kuvendi dhe një nga sektori joqeveritar, për t'i zhvilluar procedurat për parcelën e njëjtë për 15 vjet.

Hasan Përboqi: AAK, propozojmë Sinan Kryeziun.

Burim Krasniqi: LDK, nuk kemi propozim!

Sejfullah Sejfullahu: PDK, nuk kemi propozim!

Leonard Morina: LVV, propozojmë Vlora Vuçitërna!

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë, do të jeni edhe dy propozime nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritar. Nga kuvendi i komunës tani veçse i kemi: AAK – Sinan Kryeziu dhe LVV – Vlora Vuçitërna. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 abstenim, votohet pika e shtatë.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënie të pronës me qira, P-01496-0, ZK-Retijë:

Afrim Oruqi: Propozimi i kryetarit të komunës për këtë parcelë në këtë zonë është jo për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, por propozojmë që këtë parcelë përmes shprehjes së interesit ta japim në shfrytëzim minimum për 30 vite. Sipërfaqja 68 ari, 838m² prej pjesë së përgjithshme në këtë total në Retijë, me arsyetimin e vetëm që ka pasur 5-6 kërkesa për marrjen e kësaj toka, duke planifikuar që të kultivohen pemët dhe ata thonë që për 15 vjet nuk kanë llogari ta marrin. Produkti fillon të dalë në vitin e pestë ose gjashtë dhe pas dhjetë viteve përsëri duhet të futet në kuvend dhe mund ta marrë dikush tjetër. Ata kanë plan ta bëjnë plantacion dhe nëse nuk i rrisim vitet, do të dështojë ankandi.

Burim Krasniqi: Drejtor, ne si LDK e përkrahim këtë vendim për 30 vite, sepse njëri prej të interesuarve e ka shprehur të njëjtin shqetësim dhe duhen rreth 5 vite deri te prodhimi. E dyta, parcela e ka një shtrirje gjatësore përpara disa parcelave të tjera, që duhet të jenë private. Kur jepet në shfrytëzim, ta kemi në konsideratë atë pjesë që mos të bëhet telashe që në të ardhmen të bëhet e drejtë kalimi (servituti).

Kryesuesi: Nëse nuk kemi pyetje tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 17 vota “për”, votohet pika e tetë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formim të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01496-0, ZK-Retijë:

Afrim Oruqi: Faleminderit! Kemi vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01496-0. Pra, parcela e njëjtë me sipërfaqe të njëjtë në Retijë për 30 vjet.

Hasan Përboqi: AAK, propozojmë asambleistin shumë punëtor, Afrim Berisha!

Burim Krasniqi: LDK, propozojmë asambleistin pak më pak punëtor, Eqrem Spahiu!

Sejfullah Sejfullahu: PDK, duke i parë që këta qenkan punëtorë, e ne “demblela”, atëherë nuk po propozojmë hiç.

Vlora Vuçitërna: LVV, gjithashtu edhe ne ju lëmë punëtorëve, nuk kemi propozim.

Kryesuesi: Atëherë, nga kuvendi i komunës kemi: AAK, Afrim Berisha dhe LDK, Eqrem Spahiu. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (20) votohet përbërja e komisionit. Dy përfaqësues duhet të jenë nga ekzekutivi dhe një ka sektori joqeveritar.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-08994-0, ZK-Rahovec:

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për një parcelë në Rahovec. Rruga “Halil Hamza” me kubëza, një pjesë e rrugës që ka disa gurë të mëdhenj, është pronë private. Prona është e Sali Haxhijaha, në sipërfaqe të përgjithshme 4 ari e 61m². Interesi i përgjithshëm është vetëm 12m², që pas ligjshmërisë do ta këmbejmë me një pjesë të parcelës së komunës, që gjendet në anën tjetër dhe do ta lirojmë rrugën duke e bërë dykahëshe, këtu është qëllimi.

Burim Krasniqi: Drejtor, kjo nënkupton që kjo pjesa përkajë parcelës 1433-0 rrugës “Halil Hamza” i merret dhe i jepen të njëjtës rrugë dy pjesët te parcela 101-1.

Ilir Pallqa: Aty ka shumë nevojë për zgjerim, por nuk e di nëse do ta bëni ndonjë premtim zgjedhor që t'i hyni "bager" asaj rruge, deri te Faik Rama. Rruga më e dendur me shtëpi është ajo dhe atje më në lagje kanë treguar që ju premtuar që do t'iu rregulloni edhe kanalizimin.

Kryesuesi: Atëherë, e vendosim në votim pikën e dhjetë. Kush është "për"?... Konstatohet që unanimisht (19) votohet pika e dhjetë e rendit të ditës.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor):

Afrim Oruqi: Bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, me kërkesë të përfaqësuesit të autorizuar të pronarit "Esra Palace" Sh.p.k, kuvendi i komunës i Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2025, ju propozon të merrni vendim për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitut sendor) nëpër pjesë të parcelës. Bëhet fjalë për një parcelë komunale me sipërfaqe të përgjithshme 68 ari e 80m², mirëpo pjesa e parcelës ku jepet e drejta e kalimit, kësaj parcele private që është në emërtimin e lartëcekur bëhet fjalë veç për 8m². Kërkoj nga sekretariati që ta përmirësojë, sepse këtu po shkruan 7m². Qëllimi i kësaj të drejte të servitutit është që të pajiset me kushte dhe pastaj me leje, sepse kjo parcelë private që të del në rrugën publike "Xhelal Hajda – Toni" duhet t'i kalojë këto 8m². Në terren shfrytëzohet si rrugë. Këtu e kemi një skicë me koordinata dhe materialin e keni në email. Ju ftoj që ta votoni këtë të drejtë kalimi në sipërfaqe prej 8m².

Kryesuesi: Nëse nuk kemi ndonjë pyetje, pikën e 11-të e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (19) votohet edhe kjo pikë.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të pronës komunale stacionit policor në Rahovec:

Afrim Oruqi: Një parcelë e komunës në ZK Rahovec – aty ku është objekti i stacionit policor të Kosovës. Policia e Republikës së Kosovës e ka në shfrytëzim hapësirën veç sa është objekti, pjesa përpara te muri me rrethoja është pjesë e parcelës bashkë me oborrin e komunës deri te gjykata. Ata e kanë në shfrytëzim faktik para dhe pas luftës. Drejtorja e përgjithshme e policisë së Kosovës është drejtuar te ne. Ata e kanë bërë një projekt dhe dëshirojnë ta rehabilitojnë stacionin policor, duke krijuar parkingje të reja dhe kanë kërkuar prej neve që të marrim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë stacionit policor këtë parcelë me nr. 1880-2, me sipërfaqe 6 ari e 3m² për 99 vite, sipas ligjeve në fuqi.

Kryesuesi: Nëse nuk kemi ndonjë pyetje, pikën e 12-të e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (20) votohet edhe kjo pikë.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV):

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Në mbledhjen e kaluar kemi marrë vendim që ta ndajmë një lokacion prej 20 ari, për ndërtimin e objektit të institucionit të veterinarisë dhe nga ne është kërkuar që ta rishqyrtojmë. Para jush e keni plotësim-ndryshimin e vendimit dhe bëhet fjalë për zonën e njëjtë, me sipërfaqe të njëjtë. Është shtuar pika 7, që me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.01 29/25 i datës 28.03.2025.

Burim Krasniqi: Drejtor, vlerësimi i ligjshmërisë të arsytimit thotë: prej mospërputhshmërisë jeni thirrë në një pjesë në PZhK-në e 2013-tës dhe në një pjesë të PZhK-në 2023-3031. PZhK 2013 është dokument jovalid dhe tani përsëri e kemi në preambulë, nëse nuk gaboj. Më falni, në rregull qenka, paskam qenë gabim.

Kryesuesi: Nëse nuk kemi ndonjë pyetje, pikën e 13-të e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (20) votohet edhe kjo pikë.

14. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në komunën e Rahovecit, për vitin 2024-2025:

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Gjatë dy sezonave e kemi paraqitur në të shkruar informatën. Komuna e Rahovecit në këtë informatë është e ndarë në dy pjesë, sipas vendbanimeve. Ju informoj që, periudhë dimërore ka qenë data 25 dhjetor 2024, ku ka pasur të reshura të borës. Kontratat janë tri vjeçare. Në

momentin që nuk ka borë, kompanitë obligohen të bëjnë pastrimin e deponive ilegale, pastrimin e trotuareve dhe të gjitha specifikat e kontratës. Për çdo kërkesë, sugjerim, rekomandim dhe vërejtje, jemi këtu për secilin.

Eqrem Spahiu: Respekt për të gjitha kompanitë, por çka kanë për detyrë të pastrojnë, vetëm trotualet apo edhe parqet? Në fshatin tonë, të dy parqet nuk arrihen të pastrohen prej dy kompanive.

Sejfullah Sejfullahu: Njëjtë është edhe për Krushë. Atë ditë që kemi pastruar, ta kam bërë “like” dhe më vjen keq që nuk kam qenë aty. Te larja e rrugëve, nuk dua të bëhem lokalist, por ndodh që 60-70 vizitorë i kemi në ditë dhe rrugën prej shtëpisë muze duhet ta pastroni, sepse kompania prej 26 marsit nuk e ka bërë asnjëherë pastrimin e asaj rruge. Pse po ndodh kjo, a nuk ka para komuna? Tani është e nevojshme më shumë, sepse është koha e “rasadeve” dhe bëhet më shumë pluhur dhe rrugët brenda Krushës janë katastrofë.

Burim Krasniqi: Drejtor, është në rregull, e kemi ndërruar prej raportit në informatë për shkak që nuk votohet, por më vjen keq, por as informatë nuk është kjo. Këto dy kontrata kanë shumë pozicione: sa rrugë janë pastruar? Sa vegetacion është hequr? Sa kilometra janë bërë mirëmbajtje të trotuareve? Sa kripë është shpenzuar? Meqenëse nuk janë, zyrtarisht po e bëj kërkesën që kjo informatë të jetë e plotë. Sa kilometra është pastruar bora? Sa lokacione janë pastruar deri sot?

Përparim Krasniqi: Eqremi pyeti rreth parqeve: Një operator e ka mirëmbajtjen e varrezave, operatori tjetër i ka trotualet dhe parqet. Ka qenë një ngatërresë që nuk do të ndodh më, sepse do të bëhen pastrimet. Një informatë shpesh është që përveç rrugëve lokale, ne mirëmbajmë edhe rrugët rajonale që në fakt nuk na takojnë, mirëpo e bëjmë për hir të qytetarëve. Në Krushë të Madhe fillon larja e rrugëve prej 15 prillit. Ne i autorizojmë çdo herë kompanitë që, 1 ose 2 ditë para homazheve të bëjnë larjen dhe pastrimin e lapidarëve dhe varrezave. Nëse është kërkesë të vazhdohet edhe drejt muzeut, atëherë nuk ka problem, do ta autorizojmë kompaninë. Burim, sa i përket informatave shpesh do t’i dërgoj në detaje.

Burim Krasniqi: Drejtor, te çështja e mirëmbajtjes së rrugëve rajonale, ligji për rrugë e përcakton qartë: ndërtimin, renovimin, mirëmbajtjen, sinjalizimin e autoudhëve, motoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale, i bën Ministria e Infrastrukturës. Është kompetencë dhe e drejtë ligjore e tyre, ndërsa pjesa e trotuareve është investim i komunës dhe e njëjta e ka obligim për mirëmbajtje. Te pjesa e kanaleve anësore dhe pjesën e rrugës, nëse nuk arrin ministria ta mbulojë, bëheni një memorandum mirëkuptimi, sepse nuk keni të drejtë ligjore të ndërhyni.

15. Vendimi për pëlqimin paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës:

Afrim Oruqi: Në konsultim të plotë me zyrën ligjore dhe bashkë me juve, propozojmë ta plotësojmë-ndryshojmë vendimin e fundit që është marrë në muajin e kaluar për parcelën në pronë të komunës, në sipërfaqe të përgjithshme prej 28 ari e diçka. Ne kemi marrë vendim që ta japim në shfrytëzim për 99 vite 20 ari e disa metra². Sipas zyrës ligjore po e plotësojmë-ndryshojmë këtë vendim, duke e shtuar edhe parcelën tjetër në sipërfaqe prej 9 ari për të njëjtën periudhë. Gjithashtu edhe vendimin e komisionit. Në komision janë anëtarët e njëjtë dhe i njëjti komision do të merret me zhvillimin e procedurave për të dy parcelat.

Bejtullah Deliu: Faleminderit kryesues! Drejtori tha që herën e kaluar i kemi votuar 28 ari për 99 vite dhe tani shtohen edhe 9 ari? Mirë, këtë sqarim e kërkoja.

Kryesuesi: Faleminderit Bejtullah! Nëse nuk kemi diçka tjetër, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht (19) votohet pika e parë shpesh e rendit të ditës.

16. Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:

Afrim Oruqi: Në parim, sipas zyrës ligjore vendimi i parë nuk preket në asnjë pikë e në asnjë presje. Në atë vendim e shtojmë edhe një paragraf, duke e shtuar edhe parcelën tjetër. Propozoj që të vazhdojmë me anëtarë të njëjtë të komisionit, veç të shtohet parcela e dytë me këtë sipërfaqe.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diçka tjetër, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht (19) votohet pika e dytë shpesh e rendit të ditës.

17. Shfuqizimi i vendimit Nr. prot. 01 Nr.21/25, i datës 28.02.2025 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike:

Afrim Oruqi: Duke u munduar t'i rrimë qytetarëve afër, me të drejtë ata kërkojnë dhe ne bashkë me juve vendosim dhe caktojmë lokacion. E kemi bërë këtë dhe kur e kemi dërguar për ligjshmëri e kthejnë, duke thënë që kërkesën duhet ta bëj KEDS-i. Kur të shkojnë qytetarët të kërkojnë ndihmë për trafo, atyre u thonë që ta gjejnë vendin. Qytetarët drejtohen te ne, ne i kryjmë të gjitha punët dhe marrim vendim, kurse ligjshmëria thotë që duhet të shkojmë te KEDS-i. Mirë shumë, kur shkojmë te KEDS-i ose te KEK-u, ata nuk e kanë në planifikim për zhvillim dhe qytetari mbetet në mes. Ne nuk pritojmë hiç dhe e shfuqizojmë. Ditëve në vijim do t'i shikojmë mundësitë nëse mund të gjejmë zgjidhje dhe përsëri e vendosim në KPF për muajin maj.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diçka tjetër, pikën e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (19) votohet pika e tretë shtesë e rendit të ditës. Me kaq e kemi përfunduar për sot. Duke ju falënderuar për vëmendjen, shihemi në mbledhjet e radhës.

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

